

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT NGA ZJARRI DHE RREZIQET SHITESË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës për Sigurimin nga Zjarri e Rreziqet Shtesë, këtu më poshtë do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".

Shoqëria e sigurimit SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a., këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "Siguruesi".

Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit do të mbulohet sipas këtyre Kushteve të Sigurimit nga Zjarri, këtu më poshtë do të quhet shkurtimisht "i Siguruari".

Personi fizik ose juridik i përcaktuar në Policën e sigurimit dhe në dobi të të cilit lidhet kontrata, këtu më poshtë do të quhet "Përfituesi".

OBJEKTI I SIGURIMIT

2. Siguruesi ofron Sigurimin nga Zjarri për objektet e mëposhtme:

- a. pasurine e paluajtshme, ndërtesat dhe pjesë të tjera të njësisë;
- b. pasurinë e luajtshme.

3. I Siguruari mund të sigurojë pranë Siguruesit pasuri që e ka në pronësi të tij ose në çdo formë tjetër të pronësisë me kusht që të ketë një kontratë sipas kërkesave ligjore me pronarin e pasurisë apo sendit.

4. Njësi e siguruar do të konsiderohet të jenë ndërtesat ose dhomat e ndërtesave ose vendet e përcaktuara si të tilla në kontratë.

5. Nuk do të mbulohen në sigurim sendet vetiake që u përkasin dhe përdoren nga punonjësit, përveç rasteve kur janë përcaktuar shprehimisht në Policën e Sigurimit.

6. Sigurimi i pajisjeve nuk do të përfshijë:

- a. Specimenet, modelet ose kampionet, ose stampat për prodhimin e një lloji të veçantë produkti që nuk nevojiten më për prodhimin vijues;
- b. mjetet motorrike, rimorkiot ose traktorët që kërkojnë regjistrim, targë.

7. Makinat e fatit, makinat automatike për thyerjen e tërheqjen e parave, përfshirë përmbajtjet e tyre do të mbulohen në sigurim vetëm në se për to është rënë dakord shprehimisht në kontratë.

8. Objektet e mëposhtme do të sigurohen vetëm në kasaforta sipas llojit të përshkruar në kontratë:

- a. kartmonedha;
- b. dokumenta, si libreza kursimesh, libra llogarie, letra me vlerë, etj;
- c. pulla poste;
- d. monedha e medalje;
- e. metale të çmuar të papërpunuar dhe objekte të prodhuara nga metale të çmuar, përveç objekteve që shërbejnë si zbukurime dhome;
- f. bizhuteri, perla e gurë të çmuar;
- g. objekte për të cilat është rënë dakord në mënyrë të veçantë.

9. Kartmonedhat do të mbulohen gjatë orëve të punës deri në një shumë të përcaktuar shprehimisht në kontratë, pavarësisht se ato nuk janë vendosur në kasafortë, sipas llojit të parashikuar në kontratë.

RREZIQET E SIGURIMIT

10. Siguruesi dëmshpërblen të Siguararin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e:

- a. zjarrit;
- b. rufesë;
- c. eksplozionit;
- d. përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij;
- e. përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me cdo njerën prej ngjarjeve të mësipërme në përputhje me kufirin e përcaktuar në Policë.

11. Rreziqet e mbuluara përcaktohen si më poshtë:

- a. Zjarr do të konsiderohet të jetë një formë e djegies me flakë e të mirave materiale jashtë vatrës që ekziston qëllimisht për të, e aftë të vetëpërhapet dhe të vetëzgjerohet.
- b. Rrufe do të konsiderohet të jetë një shkrepje e rufesë, e cila godet një objekt drejtpërdrejt.
- c. Eksplozion do të konsiderohet të jetë një çlirim i papritur i energjisë i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve në përpjekje për zgjerim. Shpërthimi i një ene (ngrohëse, tubacione, etj.) do të merret në konsideratë si i tillë në se paret i enës është dëmtuar në atë shkallë që bën të mundur barazimin e papritur të presionit brenda dhe jashtë enës. Në se shkak për shpërthimin brenda enës është një reaksion kimik, atëherë do të dëmshpërblehet çdo dëmtim i enës, edhe në se paretet e saj nuk janë shkatërruar.

PËRJASHTIME

12. Nuk do të mbulohen dëmet e shkaktuara nga implozioni.

13. Nuk do të mbulohet fitimi i munguar dhe dëmet vijuese të çdo lloji dhe natyre të tilla si dëmet për shkak të vonesave, moskryerjes, humbjes së kontratës, gjobat etj.

14. Nuk do të mbulohen dëmet e mëposhtme:

a. dëmtimi nga zjarri i objekteve të siguruara shkaktuar nga venia e tyre në zjarre utilitare (zjarre përdorimi ose shërbimi) ose nga trajtimi i tyre me nxehtë; kjo do të zbatohet gjithashtu për objektet në të cilat ose përmes së cilave prodhohet ose përçohet zjarri ose nxehtësia utilitare;

b. djegiet sipërfaqësore, përveç se kur shkaktohen nga njeri prej rreziqeve të mbuluara në nenin 10;

c. dëmi në motorët me djegie të brendshme shkaktuar nga shpërthimet e ndodhura brenda dhomës së djegies;

d. dëmi i shkaktuar në elektorët e çelësive elektrike si rrjedhojë e presioneve të gazrave që lindin brenda tyre;

e. dëmi në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik shkaktuar nga rryma elektrike me ose pa ndodhjen e zjarrit (p.sh. si pasojë e mbirrymës, tejkalimit të kufijve normale të tensioni, mbitensionit ose nëntensionit, defekteve të izolimit si qarqe të shkurtëra, kontakte trupore ose defekte tokëzimi; kontaktit të pamjaftueshëm, mosfunksionimit të instalimeve të matjes, kontrollit ose sigurisë);

f. dëmi në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkte e rrufesë;

g. dëmi nga zjarri, i cili shkaktohet nga tërmeti.

gj. dëmi shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguararit.

h. dëmi shkaktuar direkt ose indirekt nga veprimet (akte) keqdashëse.

Me veprime (akte) keqdashëse do të kuptohet humbja, shkatërrimi ose dëmtimi (shkaktuar nga zjarri, eksplozioni ose të tjera) e Pasurisë së Siguarur shkaktuar direkt ose indirekt nga dëmtimet keqdashëse të çdo personi ose grup personash, pavarësisht nëse një akt i tillë është bërë ose jo si pasojë e prishjes së qetësisë publike.

i. dëmi i shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e anëtarëve madhore të familjes së të Siguararit

15. Siguruesi nuk do të dëmshpërblejë të Siguararin për humbje, dëmtime ose përgjegjësi që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, janë shkaktuar, rrjedhin ose janë rënduar nga:

a. lufta, pushtimi, veprime të armikut të jashtëm, veprimet luftarake (pavarësisht nëse lufta është shpallur ose jo), lufta civile, rebelimi, revolucioni, revolta, kryengritje, trazira, greva, lokauti, turbullira civile, pushteti ushtarak ose i uzurpuar, një grup personash keqdashës ose persona që veprojnë në emër të ose në lidhje me çdo organizatë politike, komploti, konfiskimi, veprimi i komandove, rekuizimi ose shkatërrimi apo dëmtimi i kryer me urdhër të çfarëdolloj qeverie de jure apo de facto ose të çdo autoriteti publik, shpalljen e ligjit të luftës, deklaramentit dhe vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, anarkia ose mosfunksionimi i shtetit, qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit;

b. reaksioni bërthamor, rrezatimi bërthamor apo ndotja radioaktive.

c. veprimi i qëllimshëm ose neglizhencës e qëllimshme apo e rëndë e të Siguararit ose përfaqësuesve të tij.

16. Nëse në rastin e një dëmi Siguruesi përdor të drejtën e tij për të mos dëmshpërblyer në bazë të përjashtimeve të nenit 15, i Siguarari do të jetë përgjegjës për të provuar se dëmi që ka ndodhur nuk ishte shkaktuar direkt ose indirekt në lidhje me këto përjashtime.

Përjashtimet e Sëmundjeve të Transmetueshme

1. Kjo policë, subjekt i të gjitha termave, kushteve dhe përjashtimeve të zbatueshme, mbulon dëmet që i atribuohen humbjes së drejtpërdrejtë fizike ose dëmtimit fizik të ndodhur gjatë periudhës së sigurimit. Rrjedhimisht dhe pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj police për të kundërtën, kjo policë nuk siguron ndonjë humbje, dëmtim, pretendim, kosto, shpenzim ose një shumë tjetër, direkt ose indirekt që rrjedh nga, i atribuohet, ose që ndodh njëkohësisht ose në ndonjë sekuençë me një Sëmundje të Transmetueshme ose frika apo kërcënimi (qoftë real apo i perceptuar) e një Sëmundje të Transmetueshme.
2. Për qëllimet e kësaj shtojce, humbje, dëmtim, pretendim, kosto, shpenzim ose një shumë tjetër, përfshin, por nuk kufizohet në, çdo kosto për pastrimin, detoksifikim, heqjen, monitorimin ose testimin:
 - 2.1. për një Sëmundje të Transmetueshme, ose
 - 2.2. e çdo pronë të siguarur këtu që preket nga një Sëmundje e tillë e Transmetueshme.
3. Siç përdoret këtu, një Sëmundje e Transmetueshme nënkupton çdo sëmundje që mund të transmetohet me anë të ndonjë substance ose agjenti nga çdo organizëm në një organizëm tjetër ku:
 - 3.1. substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet në, një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë variacion të tij, pavarësisht nëse konsiderohet i gjallë ose jo, dhe
 - 3.2. metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin, por nuk kufizohet në, transmetimin ajror, transmetimin me lëngje trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngët ose gaz ose ndërmjet organizmave, dhe
 - 3.3. sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose mirëqenien e njeriut ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin, përkeqësimin e, humbjen e vlerës së, tregtueshmërinë e ose humbjen e përdorimit të pasurisë së siguarur këtu.

4. Kjo shtojcë zbatohet për të gjitha zgjerimet e mbulimit, mbulimet shtesë, përjashtimet nga çdo përjashtim dhe mbulimet e tjera të ofruara.

Përjashtimi i Sëmundjeve Infektive

1. Kjo marrëveshje sigurimi përjashton të gjitha dëmet që janë të shkaktuara direkt ose indirekt nga një sëmundje infektive tek njerëzit, siç definohet nga Ligji Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse sipas versionit të fundit (këtu e tutje referuar si Ligji për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse), ose Ligji Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës dhe Ligji ndërkombëtar i Epidemisë (BGBl 186/1950) duke konsideruar dëmet e ndodhura gjatë epidemisë në pajtim me paragrafin 2 dhe gjatë pandemisë në pajtim me paragrafin 3.

Të njëjtat aplikohen për dëmet në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në të cilat kompanitë UNIQA zhvillojnë biznes (CEE, në përputhje me listën e kompanive të UNIQA brenda kontratës së risigurimit) – në përputhje me ligjet e vlefshme dhe të aplikueshme lokale në secilin prej këtyre vendeve.

2. Një epidemi në kuptim të këtij përjashtimi ekziston në momentin kur një sëmundje infektive definohet në pajtim me Ligjin për Sëmundjet Ngjitëse – apo ligjet dhe rregulloret e aplikueshme lokale në pajtim me paragrafin 1 dhe këtij paragrafi – shfaqet kryesisht në zonë të kufizuar kombëtare dhe autoritetet ose qeveritë përgjegjëse urdhërojnë mbyllje të afarizmit ose masa tjera kufizuese për të parandaluar shpërndarjen e infeksionit në pajtim me Ligjin për Sëmundjet Ngjitëse dhe/ose Ligjin për Epideminë ose në bazë të ligjeve tjera ose urdhëresave për tërë industrinë dhe/ose pjesë tjera të vendit dhe/ose tërë territorin e Republikës.
3. Një pandemi në kuptim të këtij përjashtimi ekziston në momentin kur Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh/WHO) vendosë për emergjencë shëndetësore në shkallë botërore (p.sh. Emergjencë Shëndetësore Publike të Shqetësimit Ndërkombëtar – PHEIC – në pajtim me Nenin 12 të Rregullores për Shëndetin Ndërkombëtar – IHR 2005). Nëse një organizatë tjetër ndërkombëtare e njohur nga Republika e Kosovës ose shtetet tjera respektive të kompanive UNIQA të listuara në paragrafin 1 dhe 2 dhe të listuara në Kontratën e risigurimeve, zë vendin e OBSh/WHO, përcaktimi duhet të bëhet nga kjo organizatë e ndryshuar.
4. Ky përjashtim nuk aplikohet në asnjë dëm fizik ose dëm në pasuri si p.sh. shkatërrim, dëm ose humbje (humbje në pasuri) e shkaktuar nga një rrezik i siguarur dhe, nëse është pajtuar në policën origjinale, ajo gjithashtu nuk aplikohet tek humbja që rezulton me ndërprerje biznesi (humbja e elementit kohor) ose që ndërlihet me shpenzimet shoqëruese të rregullimit të humbjeve kur ndërprerja vjen si pasojë e dëmeve fizike ose dëmeve në pasuri bazuar në këtë police të lëshuar.

SHPENZIME TË MBULUARA

17. Siguruesi do të dëmshpërblejë shpenzimet, përfshirë edhe ato pa efekt, që i Siguruari i ka quajtur të nevojshme të kryejë për të mënjeluar ose minimizuar dëmin (neni 53 i Kushteve të Përgjithshme). Kompensimi i këtyre shpenzimeve së bashku me dëmshpërblimin për njësitë e siguruara nuk do të kalojë shumën e siguarur për njësi. Në rastin e nënsigurimit, shpenzimet do të rimbursohen në të njëjtin përpjestim si dëmtimi, pavarësisht nga udhëzimet e dhëna nga Siguruesi.

Nuk do të dëmshpërblehen shpenzimet për shërbimet e kryera nga njësitë zjarrfikëse ose persona të tjerë të detyruar për të dhënë ndihmë në interes të popullatës si dhe kur Siguruesi provon se mjetet e përdorura dhe shpenzimet e bëra nga i Siguruari janë përdorur ose janë bërë pa kujdes.

18. Siguruesi do të rimbursojë shpenzimet që kryhen në vijim të dëmit si shpenzimet e pastrimit në vendndodhjen e dëmit, përfshirë prishjen e pjesëve të pavlefshme, heqjen e mbeturinave dhe mbetjeve të tjera në vendin më të afërt të hedhurinave dhe shpenzimet e depozitimit ose shkatërrimit të tyre (shpenzimet e prishjes dhe heqjes së mbeturinave); brenda një limiti të përcaktuar në Policën e Sigurimit, sipas një preventivi, por jo më shumë se 5% e shumës së siguarur, sidoqoftë, nuk do të mbulohen shpenzimet e pastrimit nga ndotja e tokës ose e ujit.

VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR

19. Vlera e siguarur e ndërtesave do të jetë:

- a. vlera e zëvendësimit; Vlera e zëvendësimit do të jetë vlera lokale e ndërtimit duke përfshirë shpenzimet e arkitektit dhe shpenzime të tjera të projektimit;
- b. vlera aktuale; Vlera aktuale do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të ndërtesës minus një zbritje në përputhje me gjendjen aktuale të saj, në veçanti me shkallën e amortizimit;
- c. vlera e tregut; Vlera e tregut do të jetë e barabartë me çmimin e mundshëm të shitjes së ndërtesës ose vlerën e materialit që mund të përfitojë i Siguruari nga prishja e saj.

20. Vlera e siguruar e makinerive dhe pajisjeve do të jetë:

- a. vlera e zëvendësimit; Vlera e zëvendësimit do të jetë vlera për t'u paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të të njëjtit tip dhe cilësi në një gjendje si të reja, cilado qoftë shuma më e ulët;
- b. vlera aktuale; Vlera aktuale do të jetë e barabartë me vlerën e tyre të zëvendësimit minus një zbritje në përputhje me gjendjen e tyre, në veçanti me shkallën e amortizimit;
- c. vlera e tregut; Vlera e tregut do të jete e barabarte me çmimin e mundshem te shitjes se objektit ose vleren e materialit qe mund te perfitoje i Siguruari nga shitja e pjeseve te tij.

21. Vlera e siguruar e:

- a. mallrave te prodhuara nga i Siguruari, edhe ne se nuk jane perfunduar;
- b. mallrave qe tregtohen nga i Siguruari;
- c. lendeve te para;
- d. produkteve natyrore;

do te jete shuma qe duhet paguar per blerjen ose prodhimin e objekteve te te njejit lloj dhe cilesi, cilado qofte shuma me e ulet.

e. sendeve dhe paisjeve shtepiake do te jete vlera e tyre e zevendesimit .

22. Shuma e siguruar, si rregull do te jete e barabarte me vleren e sigurimit.

Baza mbi te cilen do te percaktohet shuma e siguruar do te vendoset ne Policen e Sigurimit.

a. Per ndertesat;

- Shuma e siguruar, si rregull do te jete e barabarte me vleren e zevendesimit te saj.

- Ne qofte se vlera aktuale eshte me e vogel se 80% e vleres se zevendesimit, shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren aktuale.

- Ne qofte se vlera e tregut eshte me e vogel se vlera aktuale, shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren e tregut.

b. Per makineri dhe paisje;

- Shuma e siguruar, si rregull do te jete e barabarte me vleren e zevendesimit te tyre.

- Ne raste te veçanta kur nje makineri ose grup makinerish ose paisjesh nuk mund te perdoren me ose nuk jane te perdorshme per qellimin e te Siguarit, shuma e siguruar do te jete vlera e tregut.

c. Per mallra, lende te para etj.;

- Shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren maksimale te tyre, e cila perfaqeson vleren maksimale te mundshme te mallrave te depozituara, deklaruar me shkrim nga I Siguruari.

- Ne raste te veçanta, shuma e siguruar do te jete e barabarte me vleren mesatare te tyre, e cila perfaqeson vleren mesatare qe I Siguruari parashikon te kete gjate vitit, deklaruar me shkrim nga I Siguruari.

23. Ne rast te sigurimit ne "baze te rrezikut te pare", i cili do te deklarohet shprehimisht ne Policen e Sigurimit, shuma e siguruar do te perfaqesoje nje pjese te vleres se plote dhe Siguruesi do te paguaje ne rast demi deri ne kete shume te siguruar, duke mos zbatuar kushtin e nensigurimit.

POLICA E SIGURIMIT

24. Siguruesi i lëshon te Siguarit një dokument të nënshkruar prej tij – Policën e Sigurimit, që verteton lidhjen e kontrates se sigurimit.

25. Ne se Polica e Sigurimit humbet ose demtohet ne masen qe behet e pavlefshme, me kerkesen dhe shpenzimet e te Siguarit, Siguruesi duhet te leshoje nje dublikate te saj.

26. Kontrata e Sigurimit lidhet ne baze te kerkeses me shkrim te te Siguarit.

Siguruesi leshon Policen e Sigurimit dhe percakton primin e sigurimit ne baze te Pyetesorit dhe Kerkeses per Sigurim dhe deklarimeve te bera nga i Siguruari.

Kerkesa, njoftimet e deklarimet e tjera te te Siguarit i bashkengjiten Polices se Sigurimit dhe jane pjese perberese e saj. I Siguruari eshte pergjegjes lidhur me saktesine dhe vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te bera prej tij.

27. Siguruesi ka te drejte te verifikojte vertetesine e njoftimeve dhe deklarimeve te te Siguarit dhe te kryeje inspektime per saktesime te dhenash.

PERIUDHA E SIGURIMIT

28. Periudha e sigurimit si rregull eshte jo me pak se nje vit, pervec rasteve kur ne Policen e Sigurimit percaktohet ndryshe, por jo me pak se tre muaj, perjashtuar raste te tilla si ekspozita, panaire etj.

29. Mbulimi ne sigurim fillon ne oren 24.00 te dites se percaktuar si dite e fillimit ne Policen e Sigurimit.

Mbulimi ne sigurim perfundon ne oren 24.00 te dites se percaktuar si dite mbarimi ne Policen e Sigurimit.

30. Pergjegjesia e Siguruesit do te filloje ne momentin kohor te percaktuar ne police, edhe nese pagesa e primit te sigurimit kryhet me pare.

PRIMI I SIGURIMIT

31. I Siguruari detyrohet t'i paguaje Siguruesit primin e sigurimit ose kestet e tij sipas shumave dhe afateve te percaktuara ne kontrate.

32. Pagesa e primit te sigurimit behet prane ose agjencise se Siguruesit ku eshte leshuar Polica e Sigurimit

33. Primi i sigurimit paguhet ne monedhen e percaktuar ne Policen e Sigurimit.

34. I Siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit ne afatet e caktuara ne Policen e Sigurimit. Ne se primi ose kesti i pare i tij nuk paguhet ne afat, mbulimi ne sigurim pezullohet deri ne oren 24.00 te dites qe i Siguruari paguan shumen qe detyrohet. Kur i Siguruari nuk paguan primet ne vazhdim sipas afateve te caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24.00 e dites se pesembedhjete mbas mbarimit te afatit te pagimit dhe Siguruesi ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e Polices se Sigurimit.

Humbjet dhe demtimet e vertetuara brenda afatit te mesiperem demshperblehen vetem pasi te jete zbritur shuma e kesteve vijuese te primit te sigurimit.

35. Mospagimi ne kohe i kesitit te dyte te primit te sigurimit sjell pasojat e meposhtme:

a. Siguruesi ka te drejte te zgjidhe kontraten e sigurimit;

b. demshperblimin e reduktuar ne masen 50 per qind per humbjet dhe demtimet e vertetuara perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kesitit te pare te primit te sigurimit;

c. kthimin nga i Siguruari te demshperblimeve te paguara ne masen 50 per qind per çdo humbje apo demtim te vertetuar perpara perfundimit te afatit te mbulimit ne sigurim sipas kesitit te pare te primit te sigurimit.

36. Kur pasuria e siguruar kalon ne pronesine e nje personi tjeter, kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Ne kete rast primi i paguar i kthehet te siguruarit ne perpjestim me kohen qe mbetet deri ne mbarim te afatit te kontrates.

PJESA E ZBRITSHME

37. Ne rastet e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit do te zbatohet pjese e zbritshme dhe/ose franshize.

Per cdo rast demi Siguruesi do te zbrese nga demshperblimi i llogaritur pjesen e zbritshme te percaktuar ne Policen e Sigurimit ne shume absolute ose ne perqindje. Siguruesi nuk do te paguajë deme te veçanta qe jane nen shumen e percaktuar si franshize ne Policen e Sigurimit. Masat e pjeses se zbritshme dhe franshizes do te percaktohen ne Policen e Sigurimit.

DETYRIME

38. I Siguruari, ne kohen e lidhjes se kontrates se sigurimit, duhet te informoje me shkrim Siguruesin per te gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe qe jane thelbesore per vleresimin e rrezikut. Rrethanat jane thelbesore ne se ato jane te nje natyre te tille qe mund te influencojne vendimin e Siguruesit per te perfunduar ose jo kontraten, apo per kushtet qe duhet te vendose. Nese i Siguruari me qellim nuk e permbush kete detyrim, Siguruesi ka te drejte te ndryshoje masen e primit te sigurimit, te shumes se sigurimit ose afatin e sigurimit si dhe zgjidhjen e kontrates se sigurimit. Siguruesi mund gjithashtu te zgjidhe kontraten e sigurimit nese i eshte dhene informacion i gabuar. Primi i sigurimit nuk i kthehet te Siguruarit. Ne rast demi, Siguruesi lirohet nga detyrimi per dhenie demshperblimi kur shkak i demit eshte nje rrethane qe nuk i ishte bere e njohur atij nga i Siguruari. Keto dispozita jane te vlefshme edhe per Perfituesin, nese vertetohet nga Siguruesi se ai ka kishte dijeni per pasaktesine e deklarimeve ose harresave ne lidhje me rrezikun.

39. Pas plotesimit te kerkeses per sigurim, i Siguruari nuk mund te kryeje ose lejoje ndryshime qe sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim te Siguruesit. I Siguruari duhet te informoje menjehere me shkrim Siguruesin per çdo shtim te rrezikut per te cilen vihet ne dijeni, edhe ne se nje shtim i tille ndodh pa pelqimin e tij. Me shtim te rrezikut kuptohen rrethanat qe jane thelbesore ne se ato jane te nje natyre te tille qe mund te influencojne vendimin e Siguruesit per te perfunduar ose jo kontraten, apo per kushtet qe duhet te vendose. Ne rast te mosnjofimit te Siguruesit, ky i fundit ka te drejte te lirohet nga detyrimi per dhenien e demshperblimit.

40. Ne se i Siguruari ndermerr ose ndryshon nje veprimtari te cfaredo lloji apo madhesie, ai duhet te njoftoje menjehere me shkrim Siguruesin. Ne se ndermarrja apo ndryshimi i veprimtarise perfshin shtim te rrezikut zbatohen parashikimet e nenit 39. Nga dita qe eshte ndermarre ose ndryshuar veprimtaria, Siguruesi do te kete te drejten per nje tarife primi me te larte. Kjo nuk do te zbatohet ne se Siguruesi eshte liruar nga plotesimi i detyrimit te tij ne rast demi per shkak te shtimit te rrezikut.

41. I Siguruari duhet:

a. te plotesoje te gjitha kerkesat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri pershkruar ne rregullore, dispozita ose ne kontrate;

b. te kete te regjistruara letrat me vlere dhe dokumenta te tjere, koleksione dhe objekte te tjera per te cilat jane parashikuar qe te kryhen regjistrime, dhe t'i ruaje ato ne menyre te tille qe te mos kete mundesi te demtohen ose humbasin se bashku me objektet e siguruara.

42. Ne se i Siguruari nuk arrin te plotesoje kushtet e percaktuara me siper, Siguruesi, brenda nje muaji nga dita qe ka marre dijeni, mund te zgjidhe kontraten e sigurimit duke e njoftuar te Siguruarin me shkrim. Siguruesi do te lirohet nga detyrimi per dhenien e demshperblimit nese shkak i demit ose humbjes eshte mosplotesimi nga i Siguruari i detyrimeve me qellim ose nga neglizhenca e rende.

INTERESI I SIGURUAR

43. Nese interesi i siguruar pushon se ekzistuar pas fillimit te sigurimit si rrjedhoje e nje akti lufte ose nje veprimi administrativ ne rast lufte ose nese pushimi i interesit eshte pasoje e paevitueshme e lufte, Siguruesi ka te drejte te mbaje pjesen e primit qe i perket periudhes se mbulimit te rrezikut.

44. Ne se interesi i siguruar pushon se ekzistuar per shkak te ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, Siguruesi ka te drejten e primit per te gjithë periudhen e sigurimit.

SIGURIME TE TJERA

45. Nese i Siguruari kryen sigurim tjeter kundrejt rreziqeve te siguruara per mbulimin e objekteve te siguruara ne kete kontrate, ai duhet t'i njoftoje menjehere me shkrim Siguruesit emrin e siguruesit tjeter dhe shumen e siguruar. Nese, i Siguruari, me dashje ose per shkak te pakujdesise, nuk ploteson detyrimet e paragrafit te mesiperem, atehere Siguruesi ka te drejten e gjydhjes se kontrates se sigurimit dhe te mospagimit te demshperblimit.

46. Nese eshte percaktuar pjese e zbritshme dhe ekziston sigurim tjeter, atehere masa e demshperblimit qe perfiton i Siguruari nga te gjitha kontratat nuk mund te jete me e larte se sa masa e humbjes minus pjesen e zbritshme.

47. Nese i Siguruari kryen sigurime te tjera me qellim qe te arrije perfitime te paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

MBISIGURIMI

48. Nese shuma e siguruar e tejkalon ndjeshem vleren e sigurimit, atehere si Siguruesi ashtu edhe i Siguruari mund te kerkojne zvogelimin e shumes se siguruar, dhe primi i sigurimit do te pakesohet perkatesisht.

49. Nese i Siguruari lidh kontraten e sigurimit me qellim qe te arrije perfitime te paligjshme nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka te drejten e mbajtjes se primit te sigurimit.

NENSIGURIMI

50. Nese ne momentin menjehere para ndodhjes se ngjarjes se sigurimit shuma e siguruar eshte me e ulet se vlera e sigurimit, demshperblimi i llogaritur sipas neni 56 do te shumezohet me koeficientin e nensigurimit, i cili percaktohet si raport i shumes se siguruar ndaj vleres se sigurimit.

NGJARJA E SIGURIMIT

51. Ne rastin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit, i Siguruari duhet:

a. te njoftoje me shkrim Siguruesin menjehere duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, si dhe te njoftoje organet e rendit e njesite zjarrfikese. Nje njoftim i tille do te quhet i dhene Siguruesit menjehere ne se eshte derguar brenda 24 oreve nga ndodhja e ngjarjes;

b. t'i jape menjehere rajonit perkates te policise nje liste te objekteve te demtuara;

c. te shmange ose minimizojte humbjet ose demtimet me sa eshte e mundur dhe gjate ketyre veprimeve te ndjeke udhezimet e Siguruesit; i Siguruari eshte i detyruar te kerkoje dhenien e ketyre udhezimeve ne se lejojne kushtet;

d. te bllokoje librat e llogarise dhe deshmi te tjera te pasurise se tij;

e. te lejojte Siguruesin, me kerkesen e tij dhe per sa eshte e arsyeshme, te hetoje lidhur me shkakun dhe shumen e humbjes si dhe masen e demshperblimit, duke i dhene çdo informacion qe ndihmon hetimin;

f. ne se eshte e mundur, te mos ndryshojte asgje ne vendngjarje pa miratimin e Siguruesit;

g. t'i dorezoje Siguruesit brenda 10 diteve nga ndodhja e ngjarjes nje liste te firmosur te te gjitha objekteve te humbura, demtuara apo shkaterruara, sipas formularit te dhene nga Siguruesi, si dhe vleren per te cilen kerkon te demshperblehet.

52. Nese i Siguruari, me qellim apo per neglizhence, nuk zbaton teresisht apo pjeserisht detyrimet e mesiperme, Siguruesi çlirohet nga permbushja e detyrimeve te tij. Nese organi i rendit nuk eshte njoftuar per objektet e humbura apo demtuara ne kohe, Siguruesi ka te drejte te çlirohet nga detyrimi i tij vetem per keto objekte.

KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi për aq sa ofron mbulim sigurimi nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

DEMSHPERBLIMI

53. Nese i Siguruari perpiqet te paraqese ne menyre te shtrember ose mashtruese faktet para Siguruesit, fakte te cilat kane rendesi per mundesine ose masen e demshperblimit, Siguruesi do te çlirohet nga detyrimet e tij.

54. Nese padia per demshperblim nuk eshte paraqitur ne Gjykate brenda dy vjetesh nga data qe Siguruesi e ka refuzuar ate me shkrim, Siguruesi çlirohet nga detyrimet e tij.

55. Detyrimi i Siguruesit per demshperblim kufizohet deri ne masen e shumes se siguruar.

Demshperblimi nuk do te jete me i larte se masa e humbjes, edhe ne se ne momentin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit shuma e siguruar eshte me e larte se vlera e sigurimit.

56. Do te demshperblehet si me poshte:

a. Ndertesat ;

- ne rastin e objekteve te shkaterruara ose te humbura si pasoje e nje ngjarje sigurimi, Siguruesi do te demshperbleje vleren e siguruar sipas neneve 19 dhe 22;

- ne rastin e objekteve te demtuara si pasoje e nje ngjarje sigurimi, Siguruesi do te demshperbleje shpenzimet e riparimit qe behen te nevojshme nga demtimi, por jo me shume se vlera e siguruar sipas neneve 19 dhe 22. Kur sigurimi eshte bere ne baze te vleres aktuale do te behet nje zbritje ne perputhje me shkallen e amortizimit;

b. Makineri dhe paisje;

- ne rastin e objekteve te shkaterruara ose te humbura, Siguruesi do te demshperbleje vleren aktuale te objektit menjehere para ndodhjes se ngjarjes se sigurimit sipas neneve 20 dhe 22 dhe e percaktuar ne Policen e Sigurimit. Shpenzimet per transportin, koston e montimit, taksat doganore do te demshperblehen ne qofte se ne momentin e marrjes ne sigurim keto shpenzime jane perfshire veçanerisht ne shumen e siguruar;

- ne rastin e objekteve te demtuara Siguruesi do te demshperbleje shpenzimet e nevojshme qe duhet te behen per restaurimin e makines se demtuar ne gjendjen e meparshme sipas neneve 20 dhe 22 dhe e percaktuar ne Policen e Sigurimit, por jo me shume se vlera aktuale, menjehere para ndodhjes se ngjarjes se sigurimit;

c. mallrat;

- ne rastin e objekteve te shkaterruara, te humbura ose te demtuara, Siguruesi do te demshperbleje vleren e tyre perkatese , por jo me shume se shumata e siguruar sipas neneve 21 dhe 22 dhe e percaktuar ne Policen e Sigurimit.

d. nga demshperblimi do te zbritet vlera e pjeseve te mbetura ose te shpetuara;

e. nuk do te merren parasysh shpenzimet per punimet restauruese te vendosura nga autoritetet shteterore dhe shpenzimet shtese qe jane rrjedhoje e progresit teknologjik.

57. Demshperblimi maksimal qe do te paguaje Siguruesi per cdo dem nuk do te kaloje shumen e siguruar te rene dakord per seicilin objekt.

58. Siguruesi mund te shtyje kohen e pageses:

a. per aq kohe sa ekzistojne dyshime mbi te drejten e te Siguruarit per te marre pagesen;

b. ne qofte se jane filluar hetime penale ne lidhje me ngjarjen e sigurimit kunder te Siguruarit;

c. per aq kohe sa i Siguruari nuk paraqet dhe ploteson dokumentat e kerkuara nga Siguruesi.

59. Pas likuidimit te demshperblimit, objektet mbeten te siguruara deri ne mbarim te afatit te kontrates se sigurimit per diference midis shumes se siguruar dhe demshperblimit te paguar, duke bere per kete shenime te veçanta ne policen e sigurimit. Me kerkesen e te Siguruarit, shumata e siguruar mund te rritet per te arritur shumen origjinale duke paguar prim shtese dhe duke bere shenimet perkatese ne policen e sigurimit.

60. Siguruesi, brenda 30 diteve nga data e marrjes se dokumentave te demit nga i Siguruari, detyrohet qe:

a. te beje pagesen ne rast te demshperblimit

b. te shpjegoje arsyet e refuzimit, ne rast te refuzimit.

61. Mosmarveshjet ne qofte se nuk zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen nga gjykata e vendit ku është lëshuar Polica e Sigurimit.

SHTOJCAT

Mbulimi i Rrezigeve Shtese.

001. Termeti

002. Stuhia

003. Përmbytja

004. Rreshqitja e dheut

005. Thyerja e Xhamave

006. Vjedhja

007. Grevat dhe trazirat

001 TERMETI

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga termeti, si dhe zjarri i cili pason termetin.

Me kusht qe :

- termeti duhet te jete i regjistruar nga stacionet sizmike, si dhe te kete nje vlere jo me te vogel se 4 Balle sipas shkalles Rihter.
- ndertimi te jete bere ne perputhje me kushte sizmike te zones.
- shumja e siguruar e termetit te jete 70% e shumës se siguruar te zjarrit.

Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimet :

- ne themelet e ndertesës
- ne afresket dhe zbukurimet murale
- ne enet uje mbajtese te vendosura ne muret, gardhet ose rrethimet e jashtme
- lindur, shkaktuar, shtuar direkt ose indirekt nga reaksioni berthamor, rrezatimi berthamor ose ndotjet radioaktive
- shkaktuar nga permbytja, vershimi, valet e batices.
- humbja ose demi per shkak te shiut, bresherit, debores ose hyrjes te papastertive nepermjet dritareve te cilat nuk kane qene mbyllur ose nepermjet hapjeve te tjera, ne qofte se te tilla hapje nuk jane shkaktuar nga vete stuhia
- humbja ose demi ne objektet e vendosura jashte;
- humbja ose demi ne objektet e fiksura jashte ndertesave (p sh sinjale, ndriçuesat neon, tenda, qepena, antena radio ose televizive) linja elektrike mbitokesore, duke perfshire mbeshteteset, shtyllat ose gardhet.

002 STUHIA

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te, dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimet te stuhise.

Stuhi do te konsiderohet nje levizje ajri me force jo me te vogel se 8 shkalle (17.2 m/s ose 62 km/ore) shkaktuar nga kushtet metereologjike. Ne qofte se nuk ka matje nga stacionet metereologjike qe kjo force ere mbizoteron kur ndodh nje ngjarje, do te jete e mjaftueshme ne qofte se I Siguruari sjell te dhena qe ne afersi te zones se siguruar, stuhia shkaktonte humbje ose dëme ne ndertesat e ndertuara sic duhet ose ne objektet e tjera me rezistence te njejte ose qe duke marre parasysh konstruksionin e rregullt te ndertesese, humbja ose dëmi te jene shkaktuar vetem nga stuhia.

Siguruesi do te paguaje demshperblimin per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar nga stuhia, nese shkaterrimi ose demtimi :

- shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhise ose
- shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjese te ndertesese, peme ose objekte te tjera brenda objekteve te siguruara ose ndertesese ne te cilen jane vendosur objektet e siguruara ose
- eshte si pasoje e humbjes ose demit te shkaktuar nga stuhia ne objektet e siguruara ose elemente te ndertesese te ketyre objekteve.

Ky mbulim nuk do te shtrihet tek :

- humbja ose dëmi ne ndertesat qe nuk jane gati per shfrytezim ose objekte brenda ndertesave te tilla;
- humbja ose dëmi i shkaktuar nga permybtja ose orteku;
- humbja ose dëmi per shkak te shiut, breshherit, deboret ose hyrjes te papastertive nepermjet dritareve te cilat nuk kane qene mbyllur ose nepermjet hapjeve te tjera, ne qofte se te tilla hapje nuk jane shkaktuar nga vete stuhia
- humbja ose dëmi ne objektet e vendosura jashte;
- humbja ose dëmi ne objektet e fiksura jashte ndertesave (p sh sinjale, ndriçuesat neon, tenda, qepena, antena radio ose televizive) linja elektrike mbitokesore, duke perfshire mbeshteteset, shtyllat ose gardhet.

003 PERMYBTJA

Eshte rene dakort dhe pranuar qe pervec ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi I Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruara, te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te veprimit te permybtjes.

Permybtje do te konsiderohet rasti kur :

- uji i shtratit te qendrueshem (lumit, liqenit, detit) permybt rastesisht vendin ku eshte vendosur pasuria e siguruar, verson duke kaluar bregun, ledhet, cektinat, çan ledhet dhe digat dhe shperndahet per shkak te rrymes se ujit me nivel te larte, valeve dhe ujit te tepert nga liqenet artificiale;
- vershimi i ujit per shkak te shiut te madh, te papritur, si dhe vershimi rastesisht per shkak te rreshjeve shume te medha, gerryen gjate pjerresive, rrugeve;
- tejkalohet ngritja e nivelit te ujrave siperfaqesore dhe nentokesore, krahas me pasojat e saj, por vetem kur kjo prek trupin e objektit ne uje. Ngritja e nivelit te ujrave siperfaqesore matet sipas gjendjes mujore normale te ujit ose prurjes te tij te matur ne hidromatesin me te afert. Per çdo muaj ne veçanti konsiderohet normal niveli me I larte I ujit ose prurja e tij gjate 20 viteve te fundit, pervec rasteve kur nivelet ekstremale te ujit jane tejkaluar jashte mase;
- ky sigurim mbulon vetem demet e shkaktuara ne artikujt e siguruar gjate vershimit (permybtjes) ose menjehere pasi uji ka vershuar;
- ky sigurim nuk mbulon demet per shkak te:
 - influences mekanike te ujit brenda tubacioneve te ujit, kanaleve, tuneleve;
 - kalbezimit te thate;
 - fundosjes, uljes se tokes, qe rrjedh nga permybtja;
 - ndikimit te ujit te nendheshem ne pilota, gropa themeli ose punime te ndryshme, puse miniere, koridore nentokesore dhe gropa minerare.
 - ujit te leshuar prej sistemeve te vaditjes, me kusht qe vershimi I tij jashte nuk eshte pasoje e permybtjes;
 - vendosjes te objekteve te siguruara ne shtrate lumi ose perroi te thate dhe aktive, ose ne hapsiren midis shtratit te lumit dhe bregut te lumit (hapesira e vershimit);
 - magazinimit te mallrave jo sipas rregullave te kerkuara;
 - mallrave dhe produkteve te gateshme te cilat nuk jane vendosur dhe sistemuar ne rafte qe te jene te ngritura nga toka te pakten 20 cm.
- Ky sigurim nuk do te mbuloje demtimet ne ndertesat e ngritura mbi uje, te shkaktuar nga erozioni nga jashte; ne kanalet, tunelet ose tubacionet e ujit si dhe demet e shkaktuara nga presioni per shkak te permybtjes, n.q.s. nuk eshte rene dakort ndryshe.

1. Çdo veprim keqdashës I bere nga çdo grevist ose punonjes I pezulluar nga puna ne perkrahje te greves ose rezistences ndaj pezullimit nga puna, ose I bere gjate shrrregullimit ne pune nga çdo person qe merr pjese ne to qofte kur ky veprim eshte kryer ose jo gjate rebelimeve apo trazirave civile ; ose
2. Çdo veprimi çdo autoriteti publik qe ka per qellim shtypjen ose minimizimin e pasojave te çdo rebelimi ose trazire publike egzistuese ose qe ka per qellim parandalimin ose minimizimin e pasojave te çdo veprimi te tille si ato te referuara ne nenin 10.

Por ne rast te humbjes ose demit te shkaktuar nga çdo prej ketyre veprimeve si ato te parashikuara ne piken 2 te mesiperme nuk do te perfshihet (nese veprime te tilla nuk jane kryer gjate rebelimeve apo trazirave civile) çdo humbje ose demtim nga zjarri sido qofte shkaku I ketij zjarri ose çdo humbje apo demtim te shkaktuar gjate vjedhjes ose orvatjeve per vjedhje.

Perjashtohen nga ky mbulim :

- a) Humbja apo demtimi qe rezulton nga ndalesa totale ose e pjeseshme ose nderprerja e punes, ose vonesa e punes ose I çdo lloj procesi ose operacioni tregtar apo industrial ;
- b) Humbjet (te perkohshme ose te perhershme) te pasurise se siguruar ose te çdo pjese te saj per arsye konfiskimi, rekuizimi, ndalimi ose dhunimi te kesaj pasurie, ose dhunimi i çdo pasurie perreth qe i perket te Siguruarit, çdo mjeti transporti ose sendi te ngjashem me te ;
- c) Humbja e te ardhurave, humbja nga vonesat, humbja e tregut ose humbja/demtimi vijues apo indirekt i çdo lloji ose pershkrimi tjetër .

004 RRESHQITJA E TOKES

Eshte rene dakort dhe pranuar qe perveç ketyre neneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te dhe me kusht qe pasi i Siguruari te kete rene dakort per te paguar primin shtese, kjo Police do te zgjerohet per te mbuluar demet per objektet e siguruar te cilat jane shkaterruar ose demtuar per shkak te rreshqitjes se tokes.

Ky sigurim mbulon humbjen ose demin per shkak te rreshqitjes se siperfaqes se tokes ne zona te pjerreta, me plasaritje dhe çarje ne forme damarësh, qe shihen qarte, te cilat ne periudha te shkurtera kohe shkaktojne deformacione statike te rrezikshme ose çarje te medha ne ndertesat.

Siguruesi çlirohet nga detyrimi per te paguar kerkesat per demshperblim ne rastet kur :

- zona ku eshte vendosur ndertesat ka filluar te rreshqase perpara se te leshohet Polica e Sigurimit;
- veprimet e njeriut (si hapje kanali, germime, sizmiciteti i induktuar, etj.) çojne ne nje shkeputje tektonike siperfaqesore;
- ndodh ulje, fundosje e themeleve, cedim;
- ndodh nje rreshqitje e vogel gjeologjike e tokes dhe qe duket ne çarje te vogla te ndertesave;
- ka gropethithese, goditje ose shkaterrime te malit ndersa punohet nentoke apo mbi siperfaqen e tokes (karriera) neper galeri ose ballin e saj;
- ka rreshqitje te poshtme te strukturave te reja ose vendbanimeve ose errozion bregdetar;
- ka demtim ne ose qe duket ne levizjen e pllakave te dyshemese, nese themelet e poshtme te mureve te jashme te nderteses nuk jane te demtuara ne te njeften kohe;
- ka demtime ne muret e pishinave, verandave, tarracave, rrugeve, portave, gardheve ose kopshteve, nese ndertesat ose ngrehinat ndihmese ose garazhdet nuk jane te demtuara ne te njeften kohe;
- perdoren materiale difektoze ose demet qe rrjedhin nga te metat e mjeshterise gjate periudhes se ndertimit te themeleve;
- rreshqitja ka ardhur si rezultat i permybtjes.

Ky sigurim nuk do te mbuloje shpenzimet per permiresimin e tokes.

005 THYERJA E XHAMAVE

2. Shpenzimet e rievizjes dhe rimagazinimit të skeleteve të dritareve si dhe të paisjeve të tyre (nese nuk përfshihen në Formular);
3. Humbjet e shkaktuara nga vonesat ose ndërprerja e Biznesit;
4. Thyerja ose demtimi që vijnë si rezultat i riparimeve, zbulimeve, shtesave ose ndryshimeve në zonën përreth që është në pronesi të të Siguruarit ose thyerja ose demtimi i xhamave të vendosur në mënyrë korrekte dhe që vijnë si pasoje e këtyre thyerjeve ose demtimeve;
5. Xhamat që konstatohet se janë demtuar para fillimit të periudhës së sigurimit si dhe çdo dem vijues i këtij demti;
6. Pjesa e zbritshme e shënuar në Formular e cila duhet zbritur në çdo rast thyerje ose demti;
7. Thyerja ose demtimi i shkaktuar nga zjarri.

Kushtet

1. Klauzola e Vleresimit.

Aty ku xhamat e ndonjë lloji që janë të siguruar sipas këtij Seksioni nuk prodhohen më, atëherë vlera e xhamit të thyer do të merret sipas çmimit të fundit që disponohet nga një prodhues xhamash që është me reputacion dhe që prodhon xhama të ngjashme me xhamin e thyer.

2. Klauzola e pjeseve të shpetuara.

Në lidhje me pagesën e demshperblimit Siguruesi ka të drejtë të zbrese nga shuma e demshperblimit vlerën e çdo pjese të shpetuar dhe i Siguruarit me shpenzimet e tij, do të marrë të gjitha masat për të ruajtur pjesët e shpetuara dhe do të levizë çdo germë (a), ornament (e) dhe sende të ngjashme me to që nuk janë të ngjitura me xhamin e demtuar.

3. Klauzola e Periudhës së Sigurimit dhe Shumës së Siguruar.

Periudha e Sigurimit është e njëjte me atë të Policës së Sigurimit nga Zjarri. Shuma e siguruar është e paraqitur në Formularin e Xhamave. Kjo Shtojcë si dhe Formulari i saj i bashkëngjiten kësaj Police dhe janë pjese perberese

006. VJEDHJA

VJEDHJE do të thotë :

Humbja apo demtimi i pasurisë të siguruar të specifikuar në formular në ose nga zona për shkak të vjedhjes së kryer si pasoje e hyrjes ose dalje forcërisht ose me dhunë në ose nga pasuria përreth ose demtim të pasurisë në fjalë që do të perballojë i Siguruarit nga vjedhja ose perpjekjes për vjedhje.

DHE NQË NDETESAT NUK JANË TË SIGURUARA nga ky seksion:

Demtime (përveç demit të mbuluar nga ndonjë sigurim i zakonshëm zjarri) si rrjedhojë e kësaj vjedhje ose perpjekjeve për vjedhje në zonën rrethuese të pasurisë ose në pajimet dhe paisjet fikse të pronarit , nën pronesi të të Siguruarit ose për të cilët ai është përgjegjës ligjor si qiramarrës që nuk tejkalon në total 10 % të shumës së siguruar këtu me poshtë, në lidhje me zonën rrethuese të pasurisë ku ka ndodhur demtimi.

Percaktim

Fjala VENDNDODHJA E OBJEKTIT TË SIGURUAR që perdoret në rreziqet shtese, do të thotë ajo pjese e ndertesës të zene në veprimtari nga i Siguruarit përfshi ndonjë ndertese që nuk komunikohet me të dhe të cdo oborri ose hapsire.

Duke perjashtuar:

(a) Humbje apo demtim si pasoje e vjedhjes ose të cdo perpjekjeve për vjedhje ose nga lidhja me ndonjë anetar të stafit të të Siguruarit, administratës ose bashkëpronar në zonën përreth të pasurisë;

(b) Humbje apo demtim i parave, monedhave, banknotave, vulave, dokumentave, kontratave, kambialeve, letra me vlerë, obligacioneve dhe dokumenteve të tjera.

Me kusht që gjithmone që të gjitha nënet, kushtet apo perjashtimet e sigurimit (me perjashtim

007. Rebelimet, Grevat, Trazirat Civile.

Është rene dakort dhe pranuar që përveç këtyre nëneve, perjashtimeve, klauzolave dhe kushteve të përmbajtura në Police ose të shtuara në të dhe me kusht që pasi i Siguruarit të ketë rene dakort për të paguar primin shtese, kjo Police do të zgjerohet për të mbuluar demet për objektet e siguruar të cilat janë shkatërruar ose demtuar direkt nga :

1. Çdo veprim të kryer gjatë rebelimeve ose trazirave civile nga çdo person që merr pjesë së bashku me të tjeret në këto rebelime ose trazira civile ;

2. Çdo veprim keqdashës I bere nga çdo grevist ose punonjes I pezulluar nga puna ne perkrahje te greves ose rezistences ndaj pezullimit nga puna, ose I bere gjate shregullimit ne pune nga çdo person qe merr pjese ne to qofte kur ky veprim eshte kryer ose jo gjate rebelimeve apo trazirave civile ; ose
3. Çdo veprimi çdo autoriteti publik qe ka per qellim shtypjen ose minimizimin e pasojave te çdo rebelimi ose trazire publike egzistuese ose qe ka per qellim parandalimin ose minimizimin e pasojave te çdo veprimi te tille si ato te referuara ne nenin 10.

Por ne rast te humbjes ose demit te shkaktuar nga çdo prej ketyre veprimeve si ato te parashikuara ne piken 2 te mesiperme nuk do te perfshihet (nese veprime te tilla nuk jane kryer gjate rebelimeve apo trazirave civile) çdo humbje ose demtim nga zjarri sido qofte shkaku I ketij zjarri ose çdo humbje apo demtim te shkaktuar gjate vjedhjes ose orvatjeve per vjedhje.

Perjashtohen nga ky mbulim :

- a) Humbja apo demtimi qe rezulton nga ndalesa totale ose e pjeseshme ose nderprerja e punes, ose vonesa e punes ose I çdo lloj procesi ose operacioni tregtar apo industrial :
- b) Humbjet (te perkohshme ose te perhershme) te pasurise se siguruar ose te çdo pjese te saj per arsye konfiskimi, rekuizimi, ndalimi ose dhunimi te kesaj pasurie, ose dhunimi i çdo pasurie perreth qe i perket te Siguruarit, çdo mjete transporti ose sendi te ngjashem me te ;
- c) Humbja e te ardhurave, humbja nga vonesat, humbja e tregut ose humbja/demtimi vijues apo indirekt i çdo lloji ose pershkrimi tjetër .

Pranuar nga _____